



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICION SPECIAL: PERCEPTIMI PUBLIK PËR POLITIKËN
E JASHTME TË KOSOVËS DHE DIALOGUN ME SERBINË



Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Interpretimi i të dhënave: Donika Emini, Hulumtuese dhe Donika Marku, Asistente e Hulumtimit

Redaktimi i brendshëm: Dr. Florian Qehaja

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura mbron të drejtat dhe pronën intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit.

Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe demonstrojnë vetëm mënyrën si i perceptojnë ata institucionet. Ky nuk është vlerësim përfundimtar i punës së institucioneve subjekt i këtij studimi. Raporti do t'u shërbejë si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e fondacionit National Endowment for Democracy (NED) dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur (KFOS)



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICION SPECIAL: PERCEPTIMI PUBLIK PËR POLITIKËN
E JASHTME TË KOSOVËS DHE DIALOGUN ME SERBINË

Përmbajtja

Gjetjet kryesore të edicionit special për politikën e jashtme të Kosovës dhe dialogun me Serbinë	6
Hyrje	8
PARTNERËT STRATEGJIKË TË KOSOVËS	9
Marrëdhëniet bilaterale dhe multilaterale, siç shihen nga qytetarët e Kosovës	9
1. Kosova në raport me vendet e rajonit: mes marrëdhëniesh të shpërndara, të komplikuar dhe të mirë-lidhura	9
1.1. Aleati më i madh rajonal: Perceptimet e publikut ndaj Shqipërisë	10
1.2. Perceptimet e publikut ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi	11
1.3. Perceptimet e publikut ndaj Kroacisë e Bosnjës dhe Hercegovinës.....	14
2. Kërkimi për partnerë strategjikë: Perceptimet e publikut ndaj fuqive të mëdha..16	
2.1. Marrëdhëniet bilaterale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës: perceptimet e publikut ndaj ndikimit amerikan në Kosovë	17
2.2. Gjermania, aleati më i fuqishëm evropian i Kosovës: perceptimet e publikut ndaj ndikimit gjerman në Kosovë	19
2.3. Perceptimet e publikut ndaj Rusisë: mes armiqësisë dhe ndikimit negativ	21
2.4. Perceptimet e publikut ndaj Turqisë: përtej partneritetit ekonomik?.....	23
2.5. Britania e Madhe dhe Franca: Opinioni publik ndaj partnerëve të rëndësishëm evropianë	25
3. Kosova në raport me multilateralizmin: Perceptimet e publikut ndaj BE-së dhe NATO-s ...27	
3.1. Kosova dhe BE-ja: Perceptimet e publikut ndaj BE-së	28
3.2. Forcimi i partneriteteve: Prirjet e perceptimeve të publikut ndaj anëtarësimit në NATO	31
MARRËDHËNIET E TENSIONUARA	34
4. Perceptimet e publikut ndaj Serbisë	34
4.1. Dialogu me Serbinë: fushëbetejat e reja diplomatike?	36
4.2. Ri-definimi i normalizimit?.....	37
4.3. Ndikimi i Asociacionit/Bashkësisë së komunave serbe	40
4.4. Kush po fiton?	43
Shtojca mbi Metodologjinë.....	45

Figurat

Lista e figurave

Figura 1 Perceptimet ndaj Shqipërisë.....	11
Figura 2 Perceptimet ndaj Maqedonisë	13
Figura 3 Perceptimet ndaj Malit të Zi	14
Figura 4 Perceptimet ndaj Kroacisë.....	15
Figura 5 Perceptimet ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës.....	16
Figura 6 Perceptimet ndaj SHBA-ve dhe ndikimit amerikan në Kosovë.....	18
Figura 7 Perceptimet ndaj Gjermanisë dhe ndikimit të saj në Kosovë.....	20
Figura 8 Perceptimet ndaj Rusisë dhe ndikimit të saj në Kosovë	22
Figura 9 Perceptimet ndaj Turqisë dhe ndikimit të saj në Kosovë	24
Figura 10 Perceptimet ndaj Britanisë së Madhe.....	26
Figura 11 Perceptimet ndaj Francës.....	27
Figura 12 Perceptimet ndaj perspektivës në BE të Kosovës	29
Figura 13 Perceptimet ndaj gatishmërisë së BE-së për ta pranuar Kosovën.....	31
Figura 14 Perceptimet ndaj anëtarësimit në NATO	33
Figura 15 Perceptimet ndaj Serbisë dhe ndikimit të saj në Kosovë	36
Figura 16 Perceptimet ndaj normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.....	40
Figura 17 Perceptimet ndaj Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë	42
Figura 18 Perceptimet ndaj rezultatit të dialogut.....	44

Gjetjet kryesore të edicionit special për politikën e jashtme të Kosovës dhe dialogun me Serbinë

- Modeli i qëndrimit pozitiv ndaj **Shqipërisë** mbetet i pandryshuar përgjatë viteve. **Shqipëria** - mes të gjitha vendeve të renditura në pyetësinë e anketës konsiderohet si vendi më miqësor ndaj Kosovës dhe aleati e partneri strategjik më i madh. Njëkohësisht, rezultatet e BKS-së 2017 rikonfirmojnë prirjen e perceptimeve negative ndaj **Serbisë**. Rreth 90.0 për qind e qytetarëve e shohin Serbinë me lente negative. Për më tepër, një pjesë e madhe e të anketuarve e konsiderojnë Serbinë si një nga kërcënimet më të mëdha të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë.
- Rezultatet e BKS-së 2017 rikonfirmojnë perceptimet neutrale dhe pozitive ndaj **Maqedonisë** dhe **Malit të Zi**. **Kroacia** perceptohet si vend mik, si aleat e një partner strategjik për Kosovën - duke përfshirë edhe komponentin ushtarak. Nga ana tjetër, **Bosnja dhe Hercegovina** shihet si neutrale ndaj Kosovës.
- **Shtetet e Bashkuara të Amerikës** perceptohen si shumë miqësore ndaj Kosovës. Shtetet e Bashkuara shihen përtej kornizës së marrëdhënieve dypalëshe konvencionale; ato perceptohen më shumë si një nga aleatët dhe partnerët strategjikë më të mëdhenj të Kosovës. **Gjermania** renditet si aleati dhe partneri strategjik më i madh i Kosovës. Nga pikëpamja statistikore, 88.9 për qind e të anketuarve e cilësuan Gjermaninë si shtet shumë miqësor ndaj Kosovës. **Turqia** shihet si partner strategjik potencial për Kosovën, e ndjekur nga **Britania e Madhe** dhe **Franca**.
- Qasja e **Rusisë** ndaj Kosovës konsiderohet si shumë armiqësore. Prirja negative, ngjashëm me edicionet e mëparshme të BKS-së, u atribuohet lidhjeve të ngushta diplomatike mes Rusisë dhe Serbisë.
- Rreth **93.6** për qind besojnë se **Kosova** duhet të anëtarësohet në **BE** pavarësisht se ky mbetet "qëllim i largët". Ngjashëm, **89.0** për qind e qytetarëve besojnë se Kosova duhet të synojë anëtarësimin në **NATO**. Me përjashtim të një përqindjeje të kufizuar të të anketuarve, ndërveprimi i zgjeruar me NATO-n shihet si tregues pozitiv dhe si një shans për anëtarësimin e Kosovës në NATO.

- Shumica dërmuese e të anketuarve, saktësisht **57.3** për qind (58.0 për qind e të anketuarve shqiptarë dhe 61.0 për qind e atyre serbë) pohuan se marrëveshjet e arritura në Bruksel nuk kanë asnjë ndikim në normalizimin e marrëdhënieve.
- Rreth **73.0** për qind e të anketuarve besojnë se marrëveshja e Asociacionit është shumë e dëmshme dhe do të ketë ndikim domethënës në funksionimin e brendshëm të Kosovës. Është e domosdoshme të përmendet se një përqindje shumë e kufizuar e të anketuarve serbë, rreth 6.0 për qind, besojnë se Asociacioni do të ketë ndikim negativ në Kosovë.
- Rreth **48.5** për qind e të anketuarve shqiptarë besojnë se Serbia po përfiton më shumë se Kosova, duke iu referuar kryesisht perspektivës së anëtarësimit të Serbisë në BE, e cila kryeson procesin e integritimit në BE. Nga ana tjetër, rreth 29.3 për qind e të anketuarve serbë besojnë se Kosova po përfiton më shumë se Serbia.

Hyrje

Në prag të përvjetorit të dhjetë të pavarësisë së Kosovës, trajektorja e marrëdhënieve bilaterale dhe

multilaterale mbetet ende komplekse. Për shkak të cenueshmërisë së saj unike - kryesisht përpjekjet politike për njohje ndërkombëtare - Kosova e ka pasur më të vështirë të arrijë rezultate të favorshme në politikën e jashtme. Deri më sot, pjesa kryesore e energjisë dhe përpjekjeve kanë qenë të orientuara drejt lidhjes së marrëdhënieve me ata që nuk e kanë njohur Kosovën ose në fushata për të fituar njohje. Duke ndjekur këtë qasje, shumë njohje kanë mbetur thjesht tregues kuantitativ dhe nuk janë përcjellë me thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe. Përveç nivelit bilateral, ngjashëm me shtete të tjera të vogla Kosova ka preferuar organizatat multilaterale - ku asimetria e pushtetit mes shteteve të mëdha dhe të vogla është paksa më e zbutur. Megjithatë, kjo rrugë u pa së është edhe më e komplikuar për Kosovën. Në mungesë të njohjeve nga disa shtete kyçe anëtare - disa me fuqi vetoje dhe disa me ndikim të rëndësishëm ndërkombëtar - janë thyer edhe shpresat e Kosovës për të marrë pjesë në platformat ndërkombëtare të politikave. Përpjekjet e dështuara për t'u anëtarësuar në UNESCO dhe tërheqja nga aplikimi për anëtarësimin në Interpol reflektojnë vështirësitë politike për të depërtuar në platforma të tilla si rezultat i mungesës së agjendës së qartë të politikës së jashtme.

Me sa duket, politika e jashtme nuk është shqetësim vetëm i politikëbërësve, por edhe i qytetarëve të zakonshëm, prandaj Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë i ka përmbledhur rezultatet e opinionit publik mbi çështjet më të gjera të politikës së jashtme dhe dialogut me Serbinë në këtë format të Edicionit Special të Programit të Barometrit Kosovar të Sigurisë. Pyetjet e anketës i kanë trajtuar qëllimisht shtetet rajonale veçmas nga shtetet e tjera gjeografikisht të largëta. Në këtë mënyrë, do të dallohet mes opinioneve publike dhe përshtypjeve të fituara përmes përvojës së qytetarëve sajë marrëdhënieve më intensive dhe rritjes së mobilitetit; kurse "fuqitë e mëdha" shihen kryesisht përmes syve të mediave dhe pranisë së tyre diplomatike në Kosovë.

Organizatat ndërkombëtare kanë qenë subjekt themelor i hulumtimit sajë a) pranisë së tyre të gjerë në Kosovë, përmes prezencës së tyre aktive në formën e misioneve dhe b) aspiratave për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare, në përputhje me agjendën e politikës së jashtme të Kosovës për t'u pranuar në Kombet e Bashkuara, Bashkimin Evropian, NATO dhe platforma të tjera shumëpalëshe ndërkombëtare.

Në vijim, edicioni i posaçëm mbulon dimensionet e mëposhtme:

- Perceptimet e publikut ndaj akterëve relevantë rajonalë dhe ndërkombëtarë;
- Perceptimet e publikut ndaj organizatave ndërkombëtare, procesit të integritimit euroatlantik dhe partneriteteve të tjera potenciale strategjike;
- Perceptimet e publikut ndaj dialogut të lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë

Partnerët strategjikë të Kosovës

Marrëdhëniet bilaterale dhe multilaterale, siç shihen nga qytetarët e Kosovës

1. Kosova në raport me vendet e rajonit: mes marrëdhëniesh të shpërndara, të komplikuar dhe të mirë-lidhura

Lista e shteteve rajonale të përfshira në anketë ka mbetur e pandryshuar; ajo përbëhet nga vendet fqinjë që ndajnë kufijtë e tyre me Kosovën, pra Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Përveç tyre, ekipi i hulumtuesve të QKSS-së konsideroi edhe përfshirjen e Bosnjës dhe Hercegovinës në anketë, kryesisht për shkak të mungesës së lidhjeve diplomatike dhe qëndrimit të saj në përputhje me Serbinë në raport me Kosovën; si dhe të Kroacisë, për shkak të mbështetjes së saj të gjerë në procesin e shtet-ndërtimit, në politikën e jashtme, por edhe si aleate strategjike brenda BE-së.

Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin marrëdhëniet dhe qëndrimin e këtyre vendeve ndaj Kosovës, duke iu ofruar një spektër të vlerësimit që shkon nga cilësimet negative si shumë armiqësore dhe armiqësore, tek pozicionimi neutral dhe vlerësimi pozitiv si miqësore dhe shumë miqësore. Është e domosdoshme të qartësohet se perceptimet ndaj vendeve të rajonit janë formësuar dhe përcaktuar nga përvojat e përgjithshme të qytetarëve, por edhe nga shpeshësia e ngjarjeve diplomatike që zhvillohen përgjatë një viti (2016 - 2017). Kështu bëhet i qartë dallimi me perceptimin e përgjithshëm ndaj vendeve të tjera - fuqitë kryesore - për të cilat shumica e informacionit bazohet në mbështetjen e tyre gjatë viteve 90, në qëndrimin e tyre politik ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pra ndaj njohjes së shtetësisë, në prezencën e tyre diplomatike në Kosovë dhe në raportet e mediave.

Shtetet janë ndarë në mënyrë specifike që të pasqyrohen gjetjet kryesore të këtij edicioni të BKS-së, duke filluar me Shqipërinë, vendi që ka marrëdhëniet më intensive me Kosovën, e duke vazhduar me dy vende të tjera fqinje për të cilat të anketuarit duket

se kanë mendime neutrale, siç janë Maqedonia dhe Mali i Zi, dhe pastaj me dy vende të tjera gjeografikisht më të largëta, por të rëndësishme për opinionin publik dhe politikën e jashtme të Kosovës.

1.1. Aleati më i madh rajonal: Perceptimet e publikut ndaj Shqipërisë

Ngjashëm me edicionet e tjera të posaçme të BKS-së, mes të gjitha vendeve të renditura në pyetësinë e anketës Shqipëria konsiderohet si vendi më miqësor ndaj Kosovës dhe aleati më i madh, jo vetëm në nivel rajonal por edhe atë ndërkombëtar. Duke kapur rreth 90.0 për qind, Shqipëria u kualifikua si vendi më miqësor ndaj Kosovës. Modeli i qëndrimit pozitiv ndaj Shqipërisë mbetet i pandryshuar gjatë viteve; është e qartë se në sytë e të anketuarve (duke përjashtuar përqindjen e vogël të pakicës serbe) Shqipëria mbetet aleati kryesor i Kosovës.

Ka një spektër të gjerë faktorësh të renditur nga të anketuarit që e kanë pozicionuar Shqipërinë si një vend shumë miqësor; faktorët kryesorë që nxisin këtë perceptim lidhen me tiparet e përbashkëta kombëtare, historike, tradicionale dhe kulturore. Më e rëndësishmja, ndjenja e bazuar në përkatësinë etnike është një nga komponentët kyç që përcakton perceptimin e qytetarëve ndaj Shqipërisë. Qëndrimi pozitiv është rritur ndjeshëm nga lëvizshmëria e gjerë, kryesisht e shqiptarëve të Kosovës që udhëtojnë për në Shqipëri, çka ka krijuar një bazë solide për të zhvilluar perceptime bazuar vetëm në përvojat e tyre personale. Përveç kësaj, lista e faktorëve potencialë që ndikojnë në perceptimet ndaj Shqipërisë është e rrënjësuar edhe në shkëmbimin kulturor mes Kosovës dhe Shqipërisë. Aktivitetet dhe ngjarjet e përbashkëta mes komuniteteve artistike në të dy vendet kanë zvogëluar ndjeshëm dallimet e krijuara përgjatë historisë mes këtyre dy shoqërive.

Të dhënat cilësore të mbledhura përmes grupeve të fokusit me hulumtuesit në terren tregojnë se kur flitet për formimin e qëndrimit ndaj Shqipërisë, përveç elementeve të lartpërmendura rol vendimtar luan edhe aspekti politik. Një pjesë e madhe e qytetarëve e shohin Shqipërinë në rolin e "kumtuesit politik" ose si një zë i fortë që avokon për pjesëmarrjen e Kosovës në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Përveç komponentit të politikës së jashtme që kryesisht i atribuohet statusit politik të Kosovës në arenën ndërkombëtare, të anketuarit i perceptojnë udhëheqësit politikë shqiptarë si simbol të unitetit. Ky qëndrim vjen si rezultat i takimeve ndërqeveritare vjetore mes Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat janë zhvilluar gjatë viteve të fundit, edhe pse janë kufizuar më shumë në kuptimin e tyre simbolik, në vend që të prodhojnë bashkëpunim të prekshëm strategjik mes dy vendeve.

Nga ana tjetër, rreth 2.8 për qind ndajnë perceptime neutrale ndaj Shqipërisë, dhe megjithëse kjo përfaqëson lidhet kryesisht me të anketuarit serbë të Kosovës, ka një pjesë të vogël të të anketuarve shqiptarë që kanë shprehur zhgënjimin e tyre me Shqipërinë, dhe kjo kryesisht i atribuohet mungesës së bashkëpunimit ekonomik mes

dy vendeve. Mes këtyre të anketuarve, disa konsideronin se roli udhëheqës i Shqipërisë në rajon dhe “rivendosja e marrëdhënieve politike me Serbinë” ka ngjallur skepticizëm mes kosovarëve. Opinioni publik në Kosovë ka frikë se “de-faktorizimi” i Kosovës është vënë paksa nën hijen e “marrëdhënieve serbo-shqiptare”

Nga ana tjetër, vetëm 4.0 për qind e kanë cilësuar Shqipërinë si vend armiqësor, kështu që prirja e perceptimeve negative mbetet e ngjashme me edicionet e mëparshme. Një pjesë e madhe e të anketuarve serbë të Kosovës pranojnë faktin se Shqipëria ka qëndrim pozitiv ndaj Kosovës, por kjo nuk vlen për pakicën serbe që jeton në Kosovë, që nuk heziton të ndjekë qasjen e Beogradit ndaj Kosovës dhe Shqipërisë.

Perceptimi publik ndaj Shqipërisë




Figura 1 Perceptimet ndaj Shqipërisë

1.2. Perceptimet e publikut ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi

Teksa mendimet për Shqipërinë dhe Serbinë shprehen qartë dhe prerë, rezultatet e BKS-së 2017 për Maqedoninë dhe Malin e Zi riafirmojnë perceptimet neutrale dhe/ose pozitive ndaj këtyre vendeve. Siç shihet në figurën 2, perceptimet ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi janë mjaft të përziera, megjithatë ka një tendencë që të pozicionohen si neutralë apo miqësorë ndaj Kosovës.

Ideja bazë e qasjes pozitive ndaj këtyre vendeve është ndikuar nga vendimet e tyre politike për të njohur pavarësinë e Kosovës. Afërsia e ngushtë dhe politika e lëvizjes së lirë e Maqedonisë dhe Malit të Zi me Kosovën, konsiderohet faktor kyç për lëvizjen e gjerë të qytetarëve, duke rezultuar në perceptime të krijuara kryesisht nga përvoja e tyre personale. Nga ana tjetër, perceptimet negative mund t’i atribuohen mosmarrëve-

shjeve të mundshme (p.sh. demarkacioni i kufirit me Malin e Zi) apo ngjarjeve politike që përfshijnë komunitetet shqiptare që jetojnë në këto vende.

Në pyetjen për vlerësimin e qëndrimit të Maqedonisë ndaj Kosovës, është me rëndësi vendimtare të përmendet rritja e ndjeshme në përqindjen e atyre që e cilësojnë Maqedoninë si vend miqësor - më saktësisht nga 35.3 për qind në vitin 2016 në 43.2 për qind në vitin 2017. Rritja e qëndrimit pozitiv është shumë e lidhur me ndryshimet në qeverinë e Maqedonisë. Marrëdhënia e tensionuar, shembulli i incidentit që u zhvillua gjatë seancës plenare në parlament gjatë pjesës së parë të vitit u kthye në një histori suksesi. Deri më sot, Maqedonia ka arritur të formojë një qeveri të re duke përfshirë edhe komunitetin shqiptar që jeton në Maqedoni, me një udhëheqës që mendohet se ka qasje gjithëpërfshirëse dhe nxit barazinë e bashkimit mes të gjitha komuniteteve që jetojnë në Maqedoni. Për më tepër, diskutimi për ndryshimin e ligjit për përdorimin e gjuhës në nivel shtetëror konsiderohet si hap pozitiv drejt përmirësimit të jetës së komunitetit shqiptar dhe marrëdhënieve të përgjithshme ndëretnike në Maqedoni.

Nga pikëpamja statistikore, përqindja e të anketuarve që e konsiderojnë Maqedoninë si vend neutral ndaj Kosovës është pothuajse e balancuar me ata që kanë perceptim pozitiv. Të dhënat kualitative tregojnë se ky qëndrim bazohet kryesisht në lirinë e lëvizjes, në afërsinë me Kosovën, në kujdesin shëndetësor privat dhe në faktorë të tjerë individualë që lidhen me bashkëpunimin ekonomik (veçanërisht në rajonet kufitare me Maqedoninë).

Ky vit ka dëshmuar një rënie të ndjeshme në përqindjen e atyre që e konsiderojnë Maqedoninë vend armiqësor, më konkretisht nga 20.0 për qind në vitin 2016 ka rënë në 13.5 për qind në vitin 2017 (rezultati më i lartë ishte në vitin 2015 kur 40.0 për qind e të anketuarve e perceptonin si vend armiqësor). Faktorët që kanë shtyrë ata që e konsiderojnë Maqedoninë vend armiqësor kanë qenë të lidhur me vendimin e gjykatës mbi të ashtuquajturin "Grupin e Kumanovës", një proces që konsiderohet shumë i ndikuar nga politika që synon sulmimin e drejtpërdrejtë të komunitetit shqiptar që jeton në Maqedoni.

Perceptimi publik ndaj Maqedonisë




Figura 2 Perceptimet ndaj Maqedonisë

Ngjashëm me rastin e Maqedonisë, edhe prirja e të anketuarve për të pasur qëndrim pozitiv ndaj Malit të Zi është në rritje gjatë vitit 2017. Në shifra, përqindja e të anketuarve që kanë perceptime pozitive ndaj Malit të Zi është rritur me 6.8 për qind (nga 37.1 për qind në vitin 2016 në 43.9 për qind në vitin 2017). Teksa mund të pritej e kundërta për shkak të mosmarrëveshjes së hapur dypalëshe mbi demarkacionin e kufirit, duket se qasja pozitive është rritur si rezultat i qasjes neutrale apo “të ftohtë” të qeverisë malazeze ndaj kësaj çështjeje. Për një pjesë, çështja e demarkacionit konsiderohet më shumë si problem i brendshëm ndërmjet elitave politike në Kosovë, sesa një problemi mes dy vendeve.

Qasja neutrale e shprehur nga 44.6 për qind e të anketuarve mund t’i atribuohet lëvizshmërisë dhe lidhjeve të ngushta me komunitetin shqiptar që jeton në Mal të Zi. Nga ana tjetër, një përqindje e vogël e të anketuarve prej rreth 9 për qind e perceptojnë si armiqtësore qasjen e Malit të Zi ndaj Kosovës. Ndoshta, kjo mund t’i atribuohet ndërlidhjes së mundshme mes krizës politike të shkaktuar nga çështja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe retorikës anti-shqiptare dhe anti-kosovare të opozitës dhe të Kishës Ortodokse në Malin e Zi. Për më tepër, të anketuarit që kanë perceptime negative ndaj Malit të Zi mund ta konsiderojnë atë si pengesën kyçe në arritjen e rezultatit të vetëm të prekshëm që Kosova mund të marrë në rrugën e saj drejt BE-së.

Perceptimi publik ndaj Malit të Zi




Figura 3 Perceptimet ndaj Malit të Zi

1.3. Perceptimet e publikut ndaj Kroacisë e Bosnjës dhe Hercegovinës

Kur pyeten për qëndrimin e Kroacisë ndaj Kosovës, opinioni i të anketuarve vazhdon të mbetet pozitiv, por rezultatet kanë treguar rritje të lehtë që nga viti 2016. Nga pikëpamja statistikore, Kroacia perceptohet si vend miqësor ndaj Kosovës nga rreth 67.7 për qind e të anketuarve. Qasja kualitative tregon se Kroacia perceptohet si vend aleat dhe partner strategjik për Kosovën - duke përfshirë edhe komponentin ushtarak. Kurse rreth 27.0 për qind e shohin si vend neutral ndoshta për shkak të mungesës së bashkëpunimit intensiv të nivelit dypalësh, veçanërisht në procesin e integritimit në BE, në të cilin Kroacia nuk ka ndjekur rol udhëheqës në sigurimin e ndihmës për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor që aspirojnë të anëtarësohen në BE.

Perceptimi publik ndaj Kroacisë




Figura 4 Perceptimet ndaj Kroacisë

Kur u kërkohet të vlerësojnë qëndrimin e BH-së, një pjesë mjaft e madhe e të anketuarve, rreth 25.0 për qind, e perceptojnë Bosnjën dhe Hercegovinën si vend mik. Kjo përqindje është mjaft e madhe duke pasur parasysh mungesën e bashkëpunimit diplomatik dhe marrëdhënjet e bllokuara me Bosnjën dhe Hercegovinën. Për më tepër, rreth 45.0 për qind që e konsiderojnë si vend neutral ndaj Kosovës. E shkuara e ngjashme, veçanërisht në lidhje me agresionin serb, mund të renditet si një nga faktorët kryesorë që mbështesin qasjen pozitive, kryesisht të bazuar në dhembshuri. Një arsye tjetër mund të jetë se qytetarët mund të bëjnë një dallim të qartë mes qëndrimit të përgjithshëm të Bosnjës ndaj Kosovës dhe bllokadës së nxitur dhe ndikuar nga një-sia federale serbe - Republika Srpska.

Kur pyeten për BH-në, rreth 20.0 për qind e të anketuarve kanë perceptime negative, kryesisht duke iu referuar ndikimit serb, mungesës së marrëdhënieve dypalëshe, mungesës së lirisë së lëvizjes së mallrave dhe qytetarëve. Çka është më e rëndësishmja, qëndrimi i njëjtë me Serbinë në lidhje me pavarësinë e Kosovës, bashkë me faktin se në nivelin rajonal aspiratat e Kosovës për t'u anëtarësuar në mekanizmat e bashkëpunimit rajonal janë bllokuar kryesisht nga BH-ja, kanë kontribuar në qëndrimin e përgjithshëm negativ ndaj këtij vendi.

Perceptimi publik ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës




Figura 5 Perceptimet ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës

2. Kërkimi për partnerë strategjikë: Perceptimet e publikut ndaj fuqive të mëdha

Pozicionimi ndërkombëtar është një çështje tjetër e politikës së jashtme mjaft e diskutuar në mesin e opinionit publik në Kosovë. Gjatë dekadës së fundit, partneritetet strategjike dhe aleancat ndërkombëtare kanë zënë vend qendror në diplomacinë e Kosovës. Andaj, përveç perceptimeve për vendet e rajonit, të anketuarve iu kërkua të ndajnë perceptimet e tyre për lojtarët kryesorë globalë, disa prej të cilëve kanë ndikim të drejtpërdrejtë në agjendën e politikës së jashtme të Kosovës.

Ndryshe nga vendet e rajonit ku perceptimet kanë pasqyruar një përzjerje të opinioneve të menjëhershme politike, sociale dhe kulturore, të dhënat kualitative nga hulumtimet në terren tregojnë se perceptimet ndaj fuqive të mëdha bazohen shumë në pozicionimin e përgjithshëm të këtyre shteteve ndaj statusit politik të Kosovës, përfaqësimit diplomatik të këtyre shteteve në Kosovë, madje disa bazohen edhe në shpeshhtësinë e bashkëpunimit dhe harmonizimit me Serbinë në lidhje me statusin e Kosovës. Nuk duhet të injorohet as roli i mediave në këtë drejtim, pasi shumica e informatave që marrin qytetarët bazohen në çka thithin përmes raporteve të mediave. Rezultatet e kësaj pjese konfirmojnë "orientimin perëndimor" të opinionit publik në Kosovë, teksa një pjesë e madhe të të anketuarve e perceptojnë Gjermaninë, SHBA-të, Francën dhe Britaninë e Madhe si miqësore ndaj Kosovës. E njëjta prirje pozitive shihet në perceptimet ndaj organizatave ndërkombëtare, përkatësisht BE-së dhe NATO-s. Ng-

jashëm me edicionet e mëparshme të posaçme të BKS-së, në lidhje me Rusinë shfaqen prirje negative. Me sa duket Rusia perceptohet me negativisht, pasi shumica e të anketuarve e kanë cilësuar si vend armiqësor ndaj Kosovës.


2.1. Marrëdhëniet bilaterale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës: perceptimet e publikut ndaj ndikimit amerikan në Kosovë

Lidhjet solide diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës pas pavarësisë, përkrahja e gjerë për Kosovën gjatë gjithë procesit të shtet-ndërtimit dhe ndihma e ofruar për përmbushjen e aspiratës së Kosovës për t'u anëtarësuar në organizatat ndërkombëtare, përfaqësojnë një segment të vogël faktorësh që mbështesin qasjen pozitive të opinionit publik ndaj SHBA-ve. Në sytë e të anketuarve, qasja miqësore e SHBA-ve me Kosovën nuk kufizohet vetëm në ngjarjet e dekadës së kaluar - periudha pas pavarësisë - por edhe në mbështetjen e zëshme të SHBA-ve para dhe pas luftës së vitit 1999 në Kosovë.

Kur u kërkohet të cilësojnë pozicionimin e SHBA-ve ndaj Kosovës, ngjashëm me edicionet e mëparshme të BKS-së, SHBA-të perceptohen si vend miqësor ndaj Kosovës nga rreth 88.0 për qind e të anketuarve. Të dhënat cilësore nga hulumtimi në terren tregojnë se të anketuarit i shohin SHBA-të përtej kornizës së marrëdhënieve bilaterale konvencionale; ato perceptohen më shumë si një nga aleatët dhe partnerët strategjikë më të mëdhenj të Kosovës. Në këtë drejtim, është e domosdoshme të përmendet se administrata e re e Shteteve të Bashkuara dhe prania e përgjithshme e paqartë në rajon nuk arritën të zbehin qëndrimin pozitiv ndaj SHBA-ve, madje nga pikëpamja statistikore është vërejtur një rritje e lehtë e atyre që i perceptojnë SHBA-të si vend mik, me rreth 2.5 për qind që nga viti 2016. Në mënyrë të ngjashme, kur u pyetën për të vlerësuar ndikimin e SHBA-ve në Kosovë, një pjesë shumë e madhe e të anketuarve, gjegjësisht 95.7 për qind prej tyre deklaruan se ndikimi i SHBA-ve në Kosovë është shumë pozitiv. Ky ndikim është perceptuar të jetë shumëdimensional, duke përfshirë edhe ndikimet politike, ekonomike dhe kulturore.

Pozicionimi i SHBA-ve ndaj Kosovës dallon ndjeshëm mes të anketuarve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës. Siç shihet në tabelën e mëposhtme, prirjet negative ndaj SHBA-ve (dhe shumicës së fuqive perëndimore) u atribuohen të anketuarve serbë të Kosovës, që besojnë se ndikimi perëndimor në Kosovë është i dëmshëm dhe mbështesin qëndrimet ruse në masë të madhe.

Perceptimi publik ndaj ShBA-ve



Perceptimi publik ndaj ndikimit të ShBA-ve në Kosovë





Figura 6 Perceptimet ndaj SHBA-ve dhe ndikimit amerikan në Kosovë

2.2. Gjermania, aleati më i fuqishëm evropian i Kosovës: perceptimet e publikut ndaj ndikimit gjerman në Kosovë

Rezultatet e BKS-së 2017 rendisin Gjermaninë si aleatin më të madh të Kosovës dhe partner strategjik. Nga pikëpamja statistikore, 88.9 për qind e të anketuarve e cilësuan Gjermaninë si shtet shumë miqësor ndaj Kosovës. Ka një numër të madh faktorësh që mbështesin pozicionimin pozitiv të të anketuarve kur pyeten për Gjermaninë. Së pari, faktorët politikë përfshijnë rolin e Gjermanisë gjatë luftës së vitit 1999, por kryesisht kontributin politik në përpjekjet e Kosovës për shpalljen e pavarësisë dhe procesin e shtet-ndërtimit. Në rastin e Gjermanisë, aspekti politik ka një dimension shtesë, rolin e Gjermanisë në BE. Qëndrimi i qartë dhe i zëshëm i Gjermanisë, përkatësisht qasja e saj për reforma (ndryshe nga qasja e Brukselit), vlerësohet gjerësisht nga opinioni publik në Kosovë. Në këtë drejtim, të anketuarit e vlerësojnë lart qasjen gjermane ndaj Serbisë për t'i imponuar kushtëzimin politik, veçanërisht në raport me Kosovën. Së dyti, dy faktorë të ndërlidhur, remitancat e diasporës kosovare nga Gjermania dhe pasojat ekonomike mund të jenë mbështetës të fortë të prirjes së perceptimeve që e cilësojnë Gjermaninë si aleat shumë të fortë për Kosovën. Një tjetër faktor themelor që kontribuon në rritjen e qasjes pozitive ndaj këtij vendi është vendimi i qeverisë gjermane për të lehtësuar regjimin e lejes së punës për qytetarët e Kosovës, duke synuar që punëtorët e kualifikuar të plotësojnë nevojat e tregut të punës në Gjermani duke u ndihmuar kosovarëve të gjejnë punë në fushën e tyre të ekspertizës.

Në këtë linjë, kur u pyetën për nivelin dhe llojin e ndikimit gjerman në Kosovë, rreth 92.0 për qind e të anketuarve besojnë se është pozitiv, pasuar nga një përqindje shumë e vogël që e percepton ndikimin gjerman si negativ. Ngjashëm, rreth 3 për qind e cilësuan Gjermaninë si vend armiqësor ndaj Kosovës, një opinion kryesisht i pranishëm mes të anketuarve serbë të Kosovës.

Perceptimi publik ndaj Gjermanisë



Perceptimi i Publikut ndaj Ndikimit të Gjermanisë në Kosovë




Figura 7 Perceptimet ndaj Gjermanisë dhe ndikimit të saj në Kosovë

2.3. Perceptimet e publikut ndaj Ruisë: mes armiqësisë dhe ndikimit negativ


Në sytë e opinionit publik në Kosovë, Rusia është e lidhur me Serbinë. Kur iu kërkua të cilësojnë qasjen e Ruisë ndaj Kosovës, rreth 85.0 për qind e të anketuarve e perceptojnë si shumë armiqësore. Prirja negative, ngjashëm me edicionet e mëparshme të BKS-së, u atribuohet lidhjeve të ngushta diplomatike mes Ruisë dhe Serbisë. Kështu, argumenti i parë i renditur nga të anketuarit është i lidhur me qëndrimin e Ruisë ndaj pavarësisë së Kosovës. Është e qartë se opinionit publik e percepton Ruisë si një nga pengesat më të mëdha të integritetit të Kosovës në platformat kyçe politike ndërkombëtare, përkatësisht Kombet e Bashkuara, duke pasur parasysh fuqinë e saj të përhershme të vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së¹.

Përveç qasjes së ditur negative ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare, një tjetër çështje shqetësuese është interesi i ripërtërirë i Ruisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Të dhënat kualitative tregojnë perceptimin se Serbia po kthehet në dorën kryesore të Kremlinit në Ballkan, pasi ndikimi rus në pjesën veriore të Kosovës - zonë e banuar me serbë - përbën një nga shqetësimet kyçe për opinionin publik. Rezultatet tregojnë se forcimi i qëndrimit negativ ndaj Ruisë u ndez pas "incidentit të trenit", kur treni rus i lyer me ngjyrat serbe dhe fjalët "Kosova është Serbi" u përpoqën të hyjë në Kosovë nga Serbia. Kjo ngjarje nxiti debate dhe ngjalli frikën e një konflikti të mundshëm të armatosur mes Serbisë dhe Kosovës. Përveç kësaj, veglat ruse në pjesën veriore të Kosovës si mediat ruse dhe organizatat joqeveritare po e përhapin gjerësisht ndikimin e tyre në veri. Kështu, kur u pyetën për ndikimin rus në Kosovë, rreth 83% e të anketuarve besojnë se është shumë i dëmshëm dhe kryesisht politik. Çka është më e rëndësishmja në sytë e opinionit publik, Rusia dhe Serbia mbështesin njëra tjetrën në mënyrë që të ushqejnë ambicien e tyre për të ruajtur ndikimin në Kosovë, por edhe që të mbizotërojnë në të gjithë rajonin.

Mendimet pozitive në lidhje me qasjen e Ruisë ndaj Kosovës pasqyrohen në mesin e anketuarve serbë të Kosovës që morën pjesë në këtë anketë, konkretisht me 6.0 për qind. Ky perceptim është zhvilluar në bazë të qëndrimit të Ruisë ndaj Kosovës dhe partneritetit me Serbinë. Një tjetër faktor i rëndësishëm mund të lidhet me projektet dhe investimet në pjesën veriore të Kosovës.

1 P. Kallaba "Ndërhyrja ruse në Kosovë: si dhe pse?" 2017. E disponueshme në: http://www.qkss.org/repository/docs/Russian_interference_in_Kosovo_finale_2_735070.pdf

Perceptimi publik ndaj Rusisë



Perceptimi publik ndaj Influencës së Rusisë në Kosovë





Figura 8 Perceptimet ndaj Rusisë dhe ndikimit të saj në Kosovë

2.4. Perceptimet e publikut ndaj Turqisë: përtej partneritetit ekonomik?

Marrëdhëniet dypalëshe dhe partneriteti strategjik me Turqinë janë shumë të debatuar mes opinionit publik në Kosovë, madje ka edhe nga ata që e perceptojnë si alternativë ndaj perëndimit, veçanërisht BE-së. Kur u pyetën për qasjen e Turqisë ndaj Kosovës, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve, përkatësisht 74.5 për qind e tyre, besojnë se është partner miqësor. Teksa shumica e të anketuarve konfirmojnë se perceptimi i tyre pozitiv vjen nga ndjenja fetare, një tjetër faktor themelor që mbështet qasjen pozitive është rritja e lëvizshmërisë - kryesisht e qytetarëve kosovarë që udhëtojnë për në Turqi. Të gjendur para izolimit - kryesisht nga Perëndimi - Turqia është një nga pak vendet ku qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza. Tash e tutje, një pjesë e madhe e të anketuarve i krijojnë perceptimet e tyre bazuar në përvojat e tyre personale. Një tjetër nxitës vendimtar i qasjes pozitive është edhe bashkëpunimi ekonomik në shumë forma mes Kosovës dhe Turqisë, bashkëpunimi tregtar dhe investimet turke në vitet e fundit. Në përpjekje për të rritur investimet e huaja direkte, kontributet e çdo forme konsiderohen një hap i mirë përpara dhe kështu ndodh edhe me Turqinë në Kosovë. Në këtë drejtim, mbulimi mediatik ka kontribuar edhe më tej në krijimin e përshtypjes se Turqia është një nga investitorët më të rëndësishëm në Kosovë, ndërkohë që shumë nga këto investime kanë ardhur në formën e partneritetit publik-privat, ndryshe nga fondet zhvillimore të BE-së, për shembull. Në mënyrë të ngjashme, kur u pyetën për të vlerësuar ndikimin turk në Kosovë, rreth 74.0 për qind e të anketuarve nuk hezituan të japin përgjigje pozitive.

Një përqindje mjaft e fortë e të anketuarve duket se ishte më ngurruese në lidhje me Turqinë. Kur u pyetën rreth qasjes së Turqisë ndaj Kosovës, rreth 17 përqind e qytetarëve zgjodhën të mbeten neutralë. Neutraliteti i tyre buron nga dyshimi i arsytimit të investimeve turke, prezencës në Kosovë dhe pasojave të rritjes së ndikimit të Turqisë në Kosovë. Të dhënat cilësore tregojnë se frika nga agjenda islamike e Turqisë në Kosovë dhe përhapja e ideve fetare ekstremiste është një nga faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë hezitim. Edhe roli i disa raporteve mediatike mund të ketë ndihmuar në krijimin e këtij opinionit. Së dyti, tendenca e përgjithshme e Turqisë për të mbetur e rëndësishme në Ballkan - kryesisht duke përdorur Kosovën dhe Bosnjë dhe Hercegovinën - konsiderohet si agjendë tepër e kushtueshme politikisht për Kosovën. Për pasojë, rreth 15 për qind e qytetarëve e konsiderojnë ndikimin e Turqisë si shumë të dëmshëm për Kosovën, ndërkohë që rreth 8.0 për qind besojnë se është vend armiqësor ndaj Kosovës. Thirrjet publike të ambasadorit turk për të ndërmarrë veprime kundër disa gazetarëve për komentimin e grushtit ushtarak në Turqi në korrik 2016 dhe presioni për të arrestuar bashkëpunëtorët e supozuar të opozitës në Turqi, janë konsideruar shumë shqetësuese dhe kërcënuese për lirinë e fjalës, të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike.

Perceptimi publik ndaj Turqisë



Perceptimi publik ndaj Influencës të Turqisë në Kosovë




Figura 9 Perceptimet ndaj Turqisë dhe ndikimit të saj në Kosovë

2.5. Britania e Madhe dhe Franca: Opinioni publik ndaj partnerëve të rëndësishëm evropianë

Grupi i fundit i shteteve mes fuqive të mëdha globale është ai që përfshin Britaninë e Madhe dhe Francën, por Britania po përgatitet të dalë nga BE-ja, kurse Franca pritet që më në fund të ketë rol të rëndësishëm në rrugën e integritimit në BE për Ballkanin, përfshirë edhe Kosovën. Rezultatet e edicionit të mëparshëm të BKS-së treguan se perceptimi i përgjithshëm ndaj të dy vendeve është mjaft pozitiv.

Në sytë e opinionit publik në Kosovë, Britania e Madhe gjithmonë është perceptuar si vend miqësor ndaj Kosovës. Nga pikëpamja statistikore, rreth 77.2 për qind e të anketuarve e perceptojnë si shumë pozitive ndaj Kosovës. Kjo prirje është bazuar thjesht në ndihmën e gjerë të dhënë nga Britania e Madhe gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë por edhe në procesin e shtet-ndërtimit, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë, duke u perceptuar si aleat strategjik që ndihmon Kosovën në përmbushjen e aspiratës për të depërtuar me sukses në arenën ndërkombëtare. Është e domosdoshme të përmendet se perceptimi pozitiv ka rënë pak nga BKS-ja e mëparshme (2017). Rënia e lehtë prej rreth 7.0 për qind mund të lidhet me Brexit-in. Hezitimi është me siguri i lidhur me faktin se Kosova do të humbasë një nga aleatët më të mëdhenj brenda BE-së, një aleat që nuk është e lehtë të zëvendësohet gjatë kohës së pasigurisë brenda BE-së.

Mbretëria e Bashkuar ka gëzuar perceptim pozitiv nga të anketuarit kosovarë gjatë tre viteve të fundit. Saktësisht, 82.2 për qind e të anketuarve kishin perceptim pozitiv ndaj Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2014 dhe kjo prirje vazhdoi të rritet në vitin 2015 duke kapur 83.9 për qind. Faktorët kyç që çojnë në perceptimin pozitiv ndaj Mbretërisë së Bashkuar lidhen me përkrahjes gjatë luftës nga Mbretëria e Bashkuar së bashku me SHBA-të. Më vonë këto perceptime janë bazuar në përkrahjen që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Kosovës në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE dhe në procesin e shtet-ndërtimit në përgjithësi. Rezultatet e referendimit në Mbretërinë e Bashkuar sollën pasiguri duke u reflektuar në përgjithësi në skepticizmin e të anketuarve. Të frikësuar nga humbja e një prej mbështetësve më të mëdhenj brenda BE-së, të anketuarit ishin mjaft konfuzë në lidhje me rolin e Britanisë së Madhe në të ardhmen, duke shënuar kështu një rritje në përqindjen e atyre që e rendisin Mbretërinë e Bashkuar si neutrale. Rreth 16.5 për qind e të anketuarve e perceptojnë MB-në si vend neutral ndaj Kosovës, duke iu referuar faktit se vëmendja dhe prania e MB-së vazhdon të zbehet. Vetëm 3 përqind e të anketuarve e kanë cilësuar MB-në si shtet armiqësor ndaj Kosovës. Qëndrimi pozitiv ndaj MB-së është vërejtur edhe në mesin e serbëve të Kosovës që morën pjesë në anketë.

Perceptimi publik ndaj Britanisë së Madhe




Figura 10 Perceptimet ndaj Britanisë së Madhe

Në edicionet e mëparshme të BKS-së, opinioni publik ndaj Francës është treguar mjaft i luhatshëm. Ngjashëm, rezultatet e BKS-së 2017 tregojnë se mes të gjitha shteteve të tjera anëtare të BE-së të renditura në anketë, Franca ka marrë perceptime pozitive paksa më të ulëta krahasuar me MB-në. Kur u pyetën për qëndrimin e Francës ndaj Kosovës, mbi 59.0 për qind e të anketuarve besojnë se Franca është vend mik ndaj Kosovës. Qasja pozitive është e rrënjësor në ndihmën për Kosovën gjatë luftës, por edhe nga qëndrimi pozitiv i Francës pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova. Për më tepër, roli i Francës brenda BE-së ka kontribuar në qëndrimin e përgjithshëm pozitiv ndaj Francës. Të dhënat kualitative tregojnë se opinioni publik në Kosovë pret një qasje më proaktive të Francës në raport me Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor në përgjithësi.

Përqindja e atyre që mbeten neutralë në qëndrimin e tyre ndaj Francës është mjaft e lartë kur krahasohet me MB-në. Për shembull, rreth 39.0 për qind e të anketuarve hezitojnë ta cilësojnë Francën si vend miqësor ose armiqtësor ndaj Kosovës duke vendosur të mbeten neutralë në qëndrimin e tyre. Ky grup pasohet nga një përqindje e vogël prej 8.0 për qind e atyre që e konsiderojnë si vend armiqtësor ndaj Kosovës. Arsyet e këtij pozicionimi mund të jenë të rrënjësura në një ngjarje më të largët, siç është joefikasiteti i trupave franceze (pjesë e KFOR-it) në parandalimin e ndarjes së Mitrovicës në vitin 1999. Një tjetër faktor që mbështet këtë qëndrim janë ngjarjet që ndodhën gjatë vitit 2017. Arrestimi i ish-kreut të opozitës - tash kryeministër i Kosovës - nga autoritetet franceze bazuar në një urdhër arresti të Interpolit të lëshuar nga Serbia, duket se ka kontribuar në qasjen e përgjithshme negative ndaj Francës nga opinioni publik në Kosovë.




Figura 11 Perceptimet ndaj Francës

3. Kosova në raport me multilateralizmin: Perceptimet e publikut ndaj BE-së dhe NATO-s

Kosova i ka demonstruar qartë aspiratat e saja për t'u bërë pjesë e platformave multilaterale. Ambicia për t'u anëtarësuar në këto struktura ndërkombëtare multilaterale dhe ndërqeveritare, përkatësisht BE dhe NATO, ka qenë pjesë integrale e diskursit politik në Kosovë. Në vijim të përpjekjeve për të intensifikuar më tej marrëdhëniet me BE-në dhe duke pritur qartazi nga njëra anë hapa konkretë në procesin e integritimit në BE të Kosovës dhe nga ana tjetër marrëdhënie shumë më të komplikuara me NATO-n, QKSS e konsideroi si shumë të rëndësishme të maten perceptimet e publikut ndaj strukturave më të rëndësishme euro-atlantike. Rezultatet e BKS-së 2017 rikonfirmojnë mbështetjen e fortë dhe gatishmërinë për t'u anëtarësuar në BE dhe NATO. Për më tepër, ato dëshmojnë se opinioni publik është në përputhje me qeverinë në Kosovë kur bëhet fjalë për vendosjen e marrëdhënieve shumëpalëshe.

Përveç aspiratave për t'u anëtarësuar në BE dhe NATO, si dhe për të zhvilluar marrëdhëniet me to - pavarësisht sa komplekse janë - opinionet dhe perceptimet e dhëna në këtë pjesë janë të ndikuara shumë edhe nga misionet dhe prania e këtyre strukturave në Kosovë. Teksa kjo mund të konsiderohet pozitive për shkak të faktit se perceptimet ngrihen mbi përvoja personale, kjo mund të jetë edhe e rrezikshme, pasi i gjithë perceptimi mund të bazohet në punën e misionit, pa ditur detajet ose pa kuptuar panoramën më të gjerë.

3.1. Kosova dhe BE-ja: Perceptimet e publikut ndaj BE-së


Integrimi në BE mbetet objektivi kryesor i Qeverisë së Kosovës; si i tillë, procesi i integrimit në BE mbetet prioritet kryesor në agjendë. Ambicia për t'u anëtarësuar në BE ka ndikim në procesin e përgjithshëm të politikë-bërjes në Kosovë; kjo me reflektohet në domosdoshmërinë që i gjithë legjislacioni të jetë në përputhje me ato të BE-së. Përkundër faktit se rruga drejt BE-së ka dëshmuar se është një proces sfidues - duke pasur parasysh pengesat politike - opinioni publik në Kosovë mbetet shumë pozitiv kundrejt anëtarësimit të Kosovës në BE. Rezultatet e BKS-së 2017 tregojnë se Kosova, një nga kandidatët me më së paku shanse për t'u anëtarësuar në BE, ose për ta thënë më mirë vendi që thuhet nuk ekziston në agjendën e zgjerimit të BE-së në të ardhmen e afërt, mbetet një nga vendet më pozitive ndaj BE-së. Megjithatë, nuk shihet e njëjta qasje në pyetjen nëse BE-ja është gati të pranojë Kosovën. Kjo tregon qartë se opinioni publik është i vetëdijshëm për pengesat dhe kanë rënë prishmëritë ndaj BE-së.

Nga pikëpamja statistikore, kur u pyetën nëse Kosova duhet të aspirojë anëtarësimin në BE, shumica dërrmuese e të anketuarve, përkatësisht 93.6 për qind, u përgjigjën pozitivisht, pavarësisht se ky është një "qëllim i largët" për Kosovën. Çka është më e rëndësishmja, qasja e gjerë pozitive ndaj BE-së pasqyron faktin se BE-ja perceptohet si një nga partnerët kryesorë strategjik për Kosovën. Është e vështirë të vlerësohet saktësisht si ka ndikuar Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në opinionin publik në Kosovë; në këtë perceptim kontribuojnë më tej edhe shpjegimet e zakonshme që përfshijnë procesin e gjatë të zbatimit të MSA-së dhe mungesa e njohurive për këtë proces. Qëndrimi pozitiv ndaj anëtarësimit në BE nuk është domosdoshmërisht i bazuar në rezultatet e prekshme në procesin e integrimit në BE, si dhe nuk është i ndërlidhur me marrëdhëniet mes Kosovës dhe BE-së, por bazohet në perceptimin e përfitimeve të një vendi pas anëtarësimit në këtë strukturë. Në këtë linjë, është e rëndësishme të përmendet se të anketuarit e shohin BE-në si mekanizëm për "zgjidhje problemesh" që reagon ndaj nivelit endemik të korrupsionit, mungesës së sundimit të ligjit dhe ritmit të ngadaltë të zhvillimit ekonomik.

Perceptimi negativ, edhe pse shumë i vogël në përqindje, përfaqësohet nga rreth 3.5 për qind e të anketuarve që besojnë se Kosova nuk duhet të synojë anëtarësimin në BE. Ky perceptim është shumë i pranishëm në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës që duket se kërkojnë partneritet me Rusinë në vend të kësaj, duke u përputhur kështu me politikën e jashtme të Beogradit në këtë drejtim. Vetëm 29.87 për qind e të anketuarve serbë besojnë se Kosova nuk duhet të synojë anëtarësimin në BE, pasuar nga 33.7 për qind që refuzojnë të kenë opinion në këtë drejtim. Kjo mund të konsiderohet mjaft alarmante për BE-në, duke pasur parasysh praninë e saj të gjerë, sidomos në veri të Kosovës.

Një përqindje shumë e vogël e të anketuarve shqiptarë, vetëm 1.4 për qind, besojnë se Kosova nuk duhet të anëtarësohet në BE-në.

Perceptimi publik ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE



Perceptimi publik ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE




Figura 12 Perceptimet ndaj perspektivës në BE të Kosovës

Niveli i lartë i qëndrimit pozitiv duket se zbehet në mesin e të anketuarve kur pyeten për gatishmërinë e BE-së për ta pranuar Kosovën. QKSS-ja e ka shtuar qëllimisht këtë pyetje në anketë, duke u përpjekur të dekonstruktojë korrelacionin në mes gatishmërisë e Kosovës për t'u anëtarësuar në BE ndaj gatishmërisë së BE-së për ta pranuar Kosovën. Rezultatet reflektojnë një qëndrim mjaft të balancuar (si negativ ashtu edhe pozitiv) të të anketuarve në lidhje me këtë pyetje. Rreth 45.0 për qind e të anketuarve besojnë se BE-ja është e gatshme ta pranojë Kosovën. Argumentet e përdorura nga të anketuarit ishin kryesisht të lidhura me procesin aktual mes Kosovës dhe BE-së, përkatësisht Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Shumica dërmuese e të anketuarve që u përgjigjën pozitivisht në këtë pyetje besojnë se BE-ja është e gatshme ta pranojë një vend reformues të gatshëm të përmbushë kriteret e anëtarësimit, duke zhvendosur kështu një pjesë të fajit tek elitat politike lokale që e përdorin integrimin në BE vetëm në diskurs politik, pa ndjekur një agjendë të qartë reformuese.

Një përqindje më skeptike e të anketuarve, gjegjësisht 45.0 për qind, besojnë se BE-ja nuk është e gatshme ta pranojë Kosovën. Argumenti i që mbështet këtë qëndrim lidhet me faktin se Kosova mbetet i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor me sfida të mëdha në aplikimin për anëtarësim në BE. Negativisht perceptohet edhe kriteri shtesë për Kosovën (demarkacioni i kufirit me Malin e Zi) në procesin e liberalizimit të vizave. Të dhënat cilësore tregojnë se të anketuarit e perceptojnë këtë stagnim më shumë si përgjegjësi të përbashkët të Qeverisë së Kosovës - që nuk ratifikoi marrëveshjen e demarkacionit të kufirit si pjesë të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, dhe rasti i pashembullit i BE-së që imponon kriteret politike në një proces që është teknik dhe aspak i ndërlidhur me procesin e integritimit në BE dhe kriteret e anëtarësimit në BE².

Përveç kësaj, ka një perceptim se BE-ja ka qasje asimetrike ndaj Kosovës dhe se arritja e një konsensusi mes shteteve anëtare, veçanërisht atyre që nuk e njohin, nuk shihet në horizontin afatshkurtër. Reagimet nga diskutimet e grupeve të fokusit pasqyrojnë një qasje mjaft ngurruese të ndikuar nga sfidat ekzistuese politike, dhe janë të shumtë responentët që kanë frikë se Kosova do të ndajë një fat të ngjashëm me Maqedoninë, e cila për shkak të një çështje politike/mosmarrëveshje të hapur ju ka ndërprerë dhe penguar shumë ambicia e vendit për t'u anëtarësuar në BE.

Ngurrimi në shkallë të gjerë u pa edhe mes të anketuarve serbë, me pothuajse 60.0 për qind që besojnë se BE-ja nuk është gati ta pranojë Kosovën. Argumentet e përdorura për ta justifikuar këtë mendim ishin të lidhura ngushtë me dialogun e vazhdueshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel në kuadër të këtij procesi. Rreth 30.0 për qind e të anketuarve të pakicës serbe refuzuan të japin mendime në lidhje me këtë. Ngurrimi për t'iu përgjigjur pyetjeve të lidhura me BE-në, i cili në terma sasiorë është mjaft i lartë, mund të lidhet edhe me mungesën e përgjithshme të informacionit, apo edhe me interesin e ulët për të kuptuar procesin e integritimit në BE.

2 Kjo i detyrohet faktit se BE-ja e ka hequr regjimin e vizave me vendet jo-evropiane (p.sh. Kolumbinë dhe Tajvanin).




Figura 13 Perceptimet ndaj gatishmërisë së BE-së për ta pranuar Kosovën

3.2. Forcimi i partneriteteve: Prirjet e perceptimeve të publikut ndaj anëtarësimit në NATO

Kosova ka vendosur një agjendë të qartë të integritimit evropian, dhe këto aspirata janë hartuar me kujdes dhe janë reflektuar në strategjitë kombëtare në politikën e jashtme. Andaj, QKSS-ja ka matur vazhdimisht perceptimet e opinionit publik ndaj të gjitha strukturave dhe aleancave të synuara ndërkombëtare. NATO zë një vend veçanërisht të rëndësishëm në anketë.

Opinionimi publik ndaj anëtarësimit në NATO ka mbetur i pandryshuar përgjatë viteve, ndonëse janë dëshmuar luhajtje të vogla në varësi të ngjarjeve që ndodhin gjatë periudhës së hulumtimit në terren dhe grumbullimit të të dhënave. Rezultatet e BKS-së tregojnë se rreth 89.0 për qind e qytetarëve besojnë se Kosova duhet të anëtarësohet në NATO. Kur dekonstruktohet opinionimi publik ndaj NATO-s, duhet bërë dallim i qartë mes NATO-s të vitit 1999 dhe asaj të sotme. Ky hark kohor është i domosdoshëm kur merret parasysh roli i NATO-s gjatë ndërhyrjes ushtarake në ish Jugosllavi, që u pasua nga misioni i KFOR-it ende i pranishëm në Kosovë dhe qëndrimi politik i NATO-s në raport me Kosovën - pasi katër vendet që nuk njohin Kosovën kanë ndikim të rëndësishëm në formimin e qëndrimit të sotshëm politik të aleancës. Dhe në rastin e Kosovës, një shumicë e madhe e të anketuarve e kanë krijuar qëndrimin ndaj aleancës gjatë vitit 1999, ndërsa marrëdhëniet me NATO-n mbeten një proces politik i njohur dhe i kuptuar vetëm mes eliteve.


Pa dyshim, NATO gëzon një nivel të shëndoshë besimi mes qytetarëve të Kosovës, kryesisht bazuar në ndërhyrjen ushtarake gjatë luftës në vitin 1999. Mendimet pozitive formohen edhe nga prezenca e misionit të KFOR-it në Kosovë. Qëndrimi pozitiv është gjithashtu i pranishëm mes të anketuarve të pakicës serbe. Përkundër qasjes neutrale të NATO-s ndaj Kosovës, marrëdhëniet komplekse nuk e zbehen entuziazmin e opinionit publik në Kosovë. Çka është më e rëndësishmja, kjo pasqyron faktin se Kosova e sheh NATO-n si partner strategjik të mbrojtjes, duke u radhitur mes vendeve të tjera të rajonit/forcave ushtarake si Shqipëria, Kroacia dhe Mali i Zi - anëtarët e NATO-s - që kanë partneritetet shumë të fortë ushtarak dypalësh me Kosovën.

Me përjashtim të një përqindjeje të kufizuar të të anketuarve, ndërveprimi i zgjeruar me NATO-n shihet si tregues pozitiv dhe si një shans për anëtarësimin e Kosovës në NATO; për më tepër, ka rritur dukshmërinë dhe rolin e NATO-s në Kosovë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se sfidat në lidhje me anëtarësimin në NATO po pakësohen ose po zbuten.

Nga ana tjetër, rreth 9.0 për qind e të anketuarve përgjithësisht e kundërshtojnë anëtarësimin në NATO; perceptimi negativ është i pranishëm kryesisht në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës, të cilët e kundërshtojnë fuqishëm integrimin e Kosovës në NATO. Kjo mund të shpjegohet me faktin se në përputhje me politikën e Beogradit, të anketuarit serbë e kundërshtojnë NATO-n, duke shfaqur qartë preferencën për të forcuar partneritetin në sektorin e mbrojtjes me Rusinë.

Një hezitim i vogël është shfaqur edhe nga të anketuarit shqiptarë në lidhje me debatin mbi transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës. Çka është më e rëndësishmja, deklaratat e zyrtarëve të NATO-s në lidhje me këtë proces kanë krijuar perceptime të përziera mes të anketuarve shqiptarë. Mesazhet dhe deklaratat e përziera që kërkojnë afrimin me Beogradin nëse transformohen Forcat e Sigurisë së Kosovës, kanë kontribuar më tej në këtë hezitim në lidhje me NATO-n.

Perceptimi publik ndaj anëtarësimit të Kosovës në NATO



Perceptimi publik ndaj anëtarësimit të Kosovës në NATO




Figura 14 Perceptimet ndaj anëtarësimit në NATO

Marrëdhëniet e tensionuara

4. Perceptimet e publikut ndaj Serbisë

Në pyetjen për Serbinë, rezultatet e BKS-së 2017 rikonfirmojnë prirjen negative të perceptimeve negative ndaj këtij vendi. Ngjashëm, ose pothuajse saktësisht njësoj me edicionin e mëparshëm të vitit 2016, rreth 90 për qind e qytetarëve e shohin Serbinë me sy negativ. Kur iu kërkua të cilësojnë qëndrimin e Serbisë ndaj Kosovës, të anketuarit shqiptarë të Kosovës nuk hezituan të pasqyronin perceptimet e tyre negative. Për më tepër, një pjesë e madhe e të anketuarve e konsiderojnë Serbinë si një nga kërcënimet më të mëdha të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë.

Të dhënat cilësore të të gjitha edicioneve të BKS-së kanë treguar se shumica e perceptimeve janë të lidhura ngushtë me kujtimet e represionit dhe me luftën e vitit 1999. Ky edicion ka dëshmuar një "kthim" shumë të fortë të frikës së një konflikti të armatosur të ripërtërirë, ose sulmit të mundshëm nga Serbia. Ky perceptim është nderur nga i ashtuquajtimi incident i trenit të lyer në ngjyrat serbe dhe fjalët "Kosova është Serbi" që tentoi të kalojë kufirin kosovar. Kosova e pa këtë incident si një provokim të qëllimshëm, dhe u zotua ta ndalë trenin dhe të mbrojë integritetin territorial të Kosovës, ndërsa krerët politikë në Serbi vazhduan të deklarojnë angazhimin e tyre për të ruajtur çdo pëllëmbë të "territorit të tyre". Ky incident, i cili u zhvillua në janar 2017, krijoi një atmosferë negative dhe paralajmëroi një vit të tensionuar mes dy vendeve, me shumë potencial për agresion të përsëritur nga Serbia.

Retorika nacionaliste agresive nga politikanët serbë vazhdoi gjatë vitit 2017. Ish-presidenti i Serbisë Tomisllav Nikoliç ka deklaruar se "Serbia do të jetë e gatshme t'i dërgojë menjëherë forcat e armatosura në Kosovë, nëse është e nevojshme për të mbrojtur serbët e Kosovës". Këto deklarata u përkrahën dhe u inkurajuan plotësisht nga Kisha Ortodokse Serbe, e cila qëndron e rreshtuar kraherë me qeverinë serbe në raport me Kosovën. Kreu i kishës bëri thirrje për përdorimin e forcës për ta "rimarrë Kosovën - Jerusalemin e Serbisë" në deklaratën e tij: *Kosova mund të na merret, të jetë e pushtuar siç është sot, por*

Serbia kurrë nuk mund të thotë 'po e japim', sepse çka jepet humb përgjithmonë, ndërsa ajo që merret me forcë, merret përsëri në të njëjtën mënyrë.


Këto ngjarje treguan një nga supozimet më shqetësuese të të anketuarve shqiptarë të Kosovës; u riafirmua faktin se Serbia nuk do ta zbusë qëndrimin e saj ndaj Kosovës në periudhën afatshkurtër. Roli shkatërrues i Serbisë ndaj pavarësisë, përpjekjet e shtuara për të destabilizuar vendin dhe për të ndaluar procesin e shtet-ndërtimit në Kosovë, kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në formimin e perceptimeve ndaj Serbisë.

Përveç faktorëve të lartpërmendur, një tjetër faktor që kontribuon në perceptimet e forta negative ndaj Serbisë është shumë i lidhur me mungesën e rezultateve konkrete që rrjedhin nga dialogu i lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë. Zbatimi i dobët i marrëveshjeve të arritura në Bruksel në kuadrin e dialogut e ushqen më tej pesimizmin ndaj Serbisë. Ultimatumit i elitave politike serbe që kërcënojnë krijimin e njëanshëm të Asociacionit të Komunave Serbe nëse Qeveria e Kosovës nuk arrin ta përmbushë këtë angazhim, është akt agresion që rrezikon të zbehë progresin e kufizuar të arritur nga dialogu për normalizimin e marrëdhënieve.

Armiqësia mes vendeve vazhdoi me arrestimin në Francë të Kryeministrit aktual të Kosovës, atëherë një nga udhëheqësit e opozitës, me urdhër-arrestin e lëshuar nga Serbia në Interpol, çka zuri titujt e pothuajse të gjitha raporteve të mediave dhe nxiti më tej opinionin negativ në Kosovë. Shumë arrestime të tjera janë bërë kur qytetarët e Kosovës kanë udhëtuar nëpër Serbi - pavarësisht marrëveshjes së lëvizjes së lirë të nënshkruar në Bruksel.

Një përqindje e vogël e të anketuarve, rreth 7.0 për qind, mendojnë se qasja e Serbisë ndaj Kosovës është pozitive. Në këtë drejtim, të anketuarit serbë të Kosovës, duke përfshirë të anketuarit në pjesën veriore të Kosovës dhanë mendimin e tyre për qasjen e Serbisë ndaj Kosovës, duke e parë praninë e Serbisë në zonat e banuara nga pakica serbe si pozitive dhe të nevojshme. Megjithatë, kjo pasqyron një ndarje të qartë mes Serbisë dhe Kosovës, dhe si e tillë mund të perceptohet si pranim gradual i realitetit faktik të ekzistencës së Kosovës si shtet dhe realitetit të tyre të jetesës në Kosovë.

Perceptimi publik ndaj Serbisë



Perceptimi publik ndaj Influencës të Serbisë në Kosovë




Figura 15 Perceptimet ndaj Serbisë dhe ndikimit të saj në Kosovë

4.1. Dialogu me Serbinë: fushëbetejat e reja diplomatike?

Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë përbën një nga shtyllat kryesore në politikën e jashtme të Kosovës, por edhe sjell pasoja të mëdha në stabilitetin dhe sigurinë e brendshme politike. Ajo që synohej, të paktën teorikisht, pra normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, u degëzua dhe u ndërlidh me çështje

të tjera të politikës së jashtme, duke sfiduar ambicinet diplomatike të Kosovës. Së pari, nisja e dialogut ka pasur ndikim të madh në njohjet ndërkombëtare për Kosovën, pasi shumë shtete - ato gjeografikisht të largëta, që nuk kanë interesa të mëdha në rajon ose që janë të pavendosur në lidhje me qëndrimin e tyre ndaj pavarësisë së Kosovës - hezitojnë të marrin vendime në këtë drejtim dhe presin rezultatin e dialogut. Së dyti, është bërë ndërlidhja mes procesit të integritimit në BE për Kosovën me progresin në dialog, sidomos në zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara në kuadrin e dialogut.

Dialogu ka pasur ndikim të rëndësishëm në funksionimin e brendshëm të vendit. Qasjet kundërshtuese politike ndaj këtij procesi i kanë ndarë thellësisht elitat politike në Kosovë. Marrëveshjet e nënshkruara, kryesisht ato në kuadër të fazës politike të dialogut, kanë nxitur debate të forta në parlamentin e Kosovës dhe protesta masive të organizuara nga opozita. Kjo situatë shkaktoi ngërçin politik, çka solli në zgjedhje të parakohshme në Kosovë. Duke e përcjellë prirjen për dialog që nga fillimi i këtij procesi, QKSS-ja e konsideroi me rëndësi të madhe matjen e mëtejshme të ndikimit të dialogut brenda vendit. Rezultatet tregojnë se marrëveshjet, siç është ajo për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë, do të kenë ndikim serioz në funksionimin e vendit. Ngjashëm, numri i të anketuarve që besojnë se marrëveshjet e nënshkruara të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë po çon drejt normalizimit, mbetet shumë i ulët.

4.2. Ri-definimi i normalizimit?

Normalizimi ishte fjala kyçe e dialogut të lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë. Nga normalizimi, qëllimi i largët për të cilin u ngrit procesi i dialogut, gjendja e marrëdhënieve mes vendeve u tensionua deri në atë pikë sa që ngjarjet për parandalimin e konfliktit konsiderohen si arritje të mëdha në proces, në vend të zbatimit të marrëveshjeve që çojnë drejt normalizimit.

Kur u pyetën nëse dialogu po çon në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, shumica dërrmuese e të anketuarve, saktësisht 57.3 përqind (58.0 përqind e shqiptarëve dhe 61.0 përqind e të anketuarve serbë) pohuan se marrëveshjet e arritura në Bruksel kanë zero ndikim në normalizimin e marrëdhënieve, kështu që situata mbetet e njëjtë. Përqindja e atyre që kanë perceptimin negativ ndaj këtij procesi është rritur paksa, me 7.3 përqind që nga viti 2016.

Një nga faktorët kryesorë që lidhet me këtë qëndrim, siç u përmend nga shumica e të anketuarve, është ndërprerja e procesit për një periudhë të konsiderueshme kohore. Ky stagnim është shkaktuar nga ngjarje të brendshme politike në Kosovë dhe Serbi, siç janë zgjedhjet e parakohshme në Kosovë dhe zgjedhjet presidenciale në Serbi. Vonesa në formimin e qeverisë në Kosovë, zvarritja në emërimin e një bashkëbiseduesi të ri përgjegjës për dialogun me Serbinë, kanë pasur ndikimin e tij në stagnimin e përgjith-

shëm. Edhe vëmendja ndaj çështjeve të brendshme politike ka kontribuar në kufizimin e përpjekjeve për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese nga të dyja palët.

Fushata presidenciale në Serbi do të ishte më e "frytshme" për kandidatët që konkurronin për president duke mbështetur retorikën nacionaliste, çka ka pasur ndikim të madh në opinionet e qytetarëve ndaj Serbisë. Mentaliteti i parandalimit të konfliktit, i shkaktuar nga i ashtuquajti incident i trenit, ka pasur një ndikim domethënës në qëndrimin ndaj dialogut. Treni me simbole kombëtare serbe dhe me deklarata të forta politike si Kosova është Serbi në 21 gjuhë të ndryshme, përfshirë edhe shqip, u përpoq të hyjë në Kosovë nga Serbia (përmes linjës që lidhet me Serbinë në veri). Përfundimisht, treni u ndal nga personi që qëndronte pas kësaj ideje, presidenti serb, pasi mori përgjigje qartë nga paralajmërimi i Prishtinës për të ndaluar hyrjen e trenit në Kosovë. Ky veprim u konsiderua provokim i pastër nga Kosova. Për më tepër, nxiti frikën se retorika e nxehtë nacionaliste do të përshkallëzohej në një konflikt tjetër të armatosur. Ky incident shënoi shkëmbimet më armiqësore mes të dy palëve, sidomos që nga nisja e dialogut. Ky incident rikonfirmoi qasjen penguese të Serbisë ndaj Kosovës, ndërkohë që zvogëloi pritjet se dialogu do të zbusë qasjen e Serbisë ndaj Kosovës. Për më tepër, tregoi sa i brishtë është në realitet zbatimi i "normalizimit" të imponuar nga BE-ja, si dhe "përparimin" artificial që palët i kishin shitur BE-së pa bërë përpjekje politike për të ndryshuar situatën në terren. Viti 2017 shënon vitin e thyerjes së shpresave se dialogu i lehtësuar nga BE-ja do të çojë në njohjen e Kosovës nga Serbia. Për më tepër, incidentet në pjesën veriore të Kosovës, kryesisht të lidhura me murin e betonit të ndërtuar nga autoritetet serbe, e kanë rikthyer ndarjen etnike në Mitrovicë. Marrëveshja për heqjen e murit u arrit në Bruksel, në një takim të gjatë që synonte të zbuste tensionet mes Kosovës dhe Serbisë.


Marrëveshjet e nënshkruara për hir të "progresit" në rrugën e integritimit në BE për të dyja palët, dykuptimësia konstruktive - ose nënshkrimi i marrëveshjeve para se të jetë rënë dakord për përmbajtjen - mund të konsiderohen edhe si arsye kyçe të dështimit për të arritur atë që ishte ranë dakord në Bruksel. Në rastin e Kosovës, mungesa e konsensusit mes partive mbi pikat kryesore të marrëveshjeve ka çuar në krizë politike dhe në stagnim në zbatimin e marrëveshjeve.

Ngjarjet që kanë nxitur perceptimet negative se dialogu nuk po çon në normalizim, janë të lidhura me arrestimet e qytetarëve të Kosovës - si arrestimet e bazuara në urdhër-arrestet e lëshuara nga Serbia në Interpol, ashtu edhe ato të qytetarëve që kanë udhëtuar nëpër Serbi, duke u bazuar në marrëveshjen e lirisë së lëvizjes me BE-në. Arrestimi i ish liderit të opozitës, tash Kryeministër i Kosovës z. Haradinaj, ka shkaktuar shumë debate në Kosovë. Përgjatë pesë muajve, kërkesa e vazhdueshme ndaj autoriteteve franceze - që e arrestuan z. Haradinaj - për ekstradim e tij në Serbi ka krijuar perceptimin se Serbia vazhdon qasjen agresive ndaj Kosovës.

Ndër të anketuarit serbë, rreth 61 për qind deklaruan se dialogu nuk e ka ndryshuar situatën. Serbët e Kosovës përfaqësojnë grupin e vetëm që varet shumë nga dialogu, por ata presin edhe rezultate konkrete prej tij. Megjithatë, ata janë tepër pak të përfshirë në proces për të përcjellë pritjet e tyre, por janë “instrumentalizuar” politikisht nga të dyja palët, pa hezitim. Deri më tani, palët kanë paraqitur zero strategji si të integrohet popullsia serbe që jeton në veri të Kosovës.

Nga ana tjetër, një grup më i vogël, i përbërë nga 36.5 për qind e të anketuarve (37.6 për qind në mesin e shqiptarëve dhe 18.0 për qind mes të anketuarve serbë) besojnë se dialogu ka prodhuar rezultate të kufizuara drejt normalizimit. Kjo qasje, në mesin e të anketuarve shqiptarë u bazua në marrëveshjen e lirisë së lëvizjes, që është rezultati më i prekshëm që rrjedh nga dialogu. I njëjti grup i të anketuarve beson se pjesa më sfiduese ishte takimi i palëve për të diskutuar normalizimin, dhe duke e arritur këtë, BE-ja tashmë ka dhënë rezultate në këtë proces. Të anketuarit serbë u dukën më hezitues kur për t’iu referuar një rasti të veçantë suksesi. Komponenti i lirisë së lëvizjes nuk zbatohet për ta, pasi ka përparim të kufizuar në rritjen e lëvizshmërisë brenda Kosovës (lidhja shumë e dobët e veriut, kryesisht i banuar nga serbët, me jugun e Kosovës). Një përqindje shumë e vogël e të anketuarve besojnë se marrëveshjet kanë pasur ndikim dhe kanë normalizuar marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, duke reflektuar pra një proces të drejtuar nga tërësisht nga elitat dhe të shkëputur nga nevojat e qytetarëve.

Perceptimi publik mbi normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë



Perceptimi publik mbi normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë




Figura 16 Perceptimet ndaj normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë

4.3. Ndikimi i Asociacionit/Bashkësisë së komunave serbe

Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe (AKSHS) u nënshkrua nga të dyja palët në gusht 2015, nën patronazhin e fazës politike të dialogut. Shumë shpejt, përmbajtja dhe qëllimi i kësaj marrëveshjeje nxitën debate mes

qeverisë dhe opozitës në Kosovë. Kjo marrëveshje pati ndikim shumë-dimensional në Kosovë; ndikimi i jashtëm lidhet me angazhimin për të zbatuar marrëveshjet në Bruksel dhe ultimatumet nga Beogradi, që u angazhuar për themelimin e njëanshëm të Asociacionit, pa pëlqimin e Prishtinës.

Brenda vendit, AKSHS-ja, e parë si një model i ngjashëm me atë të Republika Srpska në Bosnjë dhe Hercegovinë, ngjalli frikën për ndikimin e ardhshëm në funksionimin e brendshëm të Kosovës. Pas gabimit të bërë me vendosjen e përfaqësimit me një parti të vetme për pakicën serbe në Kosovë, siç është Lista Srpska që punon vetëm sipas direktivave të Beogradit, themelimi i një asociacioni me fuqi ekzekutive do të forconte më tej mundësinë dhe frikën se asociacioni shumë shpejt do të “instrumentalizohet” nga Beogradi për të dëmtuar nga brenda proceset politike në Kosovë. Për më tepër, një asociacion i ndarë mbi baza etnike do të kontribuonte në izolimin e mëtejshëm të serbëve të Kosovës nga shqiptarët e Kosovës, pra është kundër shtetit multi-etnik të përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës.

Marrëveshja për Asociacionin dhe statutin e tij u kthye në një nga arsyet që çuan në ngërçin politik në Kosovë dhe në rritjen e pakënaqësisë me qeverinë në Kosovë, si dhe me pasojat dhe të ardhmen e dialogut me Serbinë. Marrëveshja u dërgua për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Vendimi i gjykatës, edhe pse i shkruar në një gjuhë të mjegullt - ngjashëm me përmbajtjen e mjegullt të marrëveshjes, përcaktoi se marrëveshja nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës në pesë pika.


Duke u përballur me ngërçin politik, zgjedhjet e parakohshme, qëndrimet kundërshtuese ndaj Asociacionit dhe frikën nga ndikimi më i zgjeruar i Serbisë në çështjet e brendshme të Kosovës, shumica e të anketuarve kishin perceptime negative kur u pyetën rreth Asociacionit. Rreth 73.0 për qind e të anketuarve besojnë se marrëveshja e Asociacionit shumë e dëmshme dhe do të ketë ndihim domethënës në funksionimin e brendshëm të Kosovës. Është e domosdoshme të përmendet se një përqindje shumë e kufizuar e të anketuarve serbë, rreth 6.0 për qind, besojnë se Asociacioni do të ketë ndikim negativ në Kosovë. E lënë jashtë procesit të dialogut, e përdorur politikisht nga Prishtina dhe Beogradi, pakica serbe në Kosovë duket se ka pritshmëri të larta për Asociacionin.

Rreth 15.6 për qind e të anketuarve besojnë se është neutral. Në pjesën më të madhe të kohës, opsioni neutral në vlerësim tregon mungesën e informacionit, ose mungesën e aftësisë për të parashikuar se çfarë do të sjellë Asociacioni, gjithashtu tregon se të anketuarit nuk kanë informacion në lidhje me të. Për këtë, ndikim të rëndësishëm ka pasur qasja e dykuptimësisë konstruktive e BE-së.

Nga ana tjetër, përqindja e atyre që besojnë se Asociacioni do të ketë ndikim pozitiv në funksionimin e brendshëm të Kosovës është mjaft e lartë në mesin e pakicës serbe. Rreth 50.0 përqind e të anketuarve serbë besojnë se është pozitiv, duke e parë Asociacionin si një mjet për të përcjell mesazhet e tyre dhe përmirësuar jetën e tyre në Kosovë. Është me rëndësi vendimtare të përmendet se mes të anketuarve serbë, një

përqindje mjaft e lartë prej rreth 25.0 për qind refuzuan të japin opinion në lidhje me këtë, duke reflektuar qartë hezitimin për ta parë Asociacionin si mekanizëm të ndryshimit në Kosovë.

Perceptimi publik mbi themelimin e Asociacionit të komunave Serbe në Kosovë



Perceptimi publik mbi themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë




Figura 17 Perceptimet ndaj Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë

4.4. Kush po fiton?


Pas çdo raundi të dialogut renditën fituesit dhe humbësit e raundit të dialogut. Dykuptimësia konstruktive luajti një rol shumë të rëndësishëm në neutralizimin e konkurrencës mes palëve dhe opinioneve publike në të dyja anët. Tekstet e hartuara me kujdes kanë dhënë mundësinë që secila parti të pretendojë fitore dhe triumfalizëm. Mungesa e transparencës çoi në keqkuptime mes qytetarëve, dhe formulimi diplomatik i BE-së, së bashku me mediat e njëanshme lokale, nuk siguroi informacion të mjaftueshëm për publikun e gjerë.

Kur u pyetën se kush përfiton më shumë nga dialogu, secila palë shfaqti prirjen ta konsiderojë tjetrën si fituese. Ky perceptim është zhvilluar kryesisht për shkak të mungesës së informacionit të mjaftueshëm në lidhje me dialogun, mungesës së besimit ndaj qeverive përkatëse dhe dykuptimësisë konstruktive të BE-së. Kriteret kryesore të përdorura për të matur përfitimet e palës tjetër nga dialogu janë të ndryshme për secilën palë, por emëruesi i përbashkët ishte progresi në procesin e integritimit në BE. Kështu, 48.5 për qind e të anketuarve shqiptarë besojnë se Serbia po përfiton më shumë se Kosova, dhe kjo i referohet perspektivës së anëtarësimit në BE për Serbinë që kryeson procesin e integritimit në BE. Por vetëm 5.3 për qind e serbëve e konsiderojnë Serbinë si fituese. Kjo është e lidhur me statusin e Kosovës dhe ndjenjën e humbjes së diçkaje të madhe për të përparuar në rrugën e integritimit në BE. Rreth 29.33 për qind e të anketuarve serbë besojnë se Kosova po përfiton më shumë se Serbia, dhe vetëm 9.4 përqind e të anketuarve shqiptarë besojnë se kjo është e vërtetë. Përqindja e vogël e atyre që besojnë se Kosova po përfiton - ndër të anketuarit shqiptarë - lidhet me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e cila sipas tyre hap mundësinë për anëtarësim në BE për Kosovën.

Rreth 21.7 për qind e shqiptarëve dhe 33.3 për qind e serbëve besojnë se asnjëra palë nuk përfiton, duke e parë dialogun më shumë si agjendë e BE-së për të fituar besueshmëri globale si negociatore. Nga ana tjetër, 16.0 për qind e shqiptarëve dhe 12.0 e serbëve e shohin këtë proces si të dobishëm për të dyja palët, duke pohuar se do të zgjidhë mosmarrëveshjen më të madhe dypalëshe në rajon dhe do të hapë rrugën drejt BE-së.

Një pjesë solide prej 20.0 për qind e të anketuarve serbë nuk pranoi t'i përgjigjet kësaj pyetjeje, çka reflekton nivelin e njohurive të tyre procesit, pasuar nga 4.0 përqind e të anketuarve shqiptarë që zgjodhën të mos përgjigjen në pyetje.

Perceptimi publik mbi Rezultatit e Dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë



Perceptimi publik mbi Rezultatit e Dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë




Figura 18 Perceptimet ndaj rezultatit të dialogut

Shtojca mbi Metodologjinë

- Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i posaçëm i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), e themeluar në shtator të vitit 2012.
- Fokusi i tij parësor është matja e besimit të publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë, si dhe matja e perceptimit të qytetarëve për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë.
- BKS-ja është punimi i parë dhe më i madh i këtij lloji i projektuar, zbatuar dhe komunikuar nga një qendër studimore lokale në Kosovë.
- Çka e bën BKS-në unike në Kosovë, është neutraliteti i tij politik. Si qendër studimore e pavarur, QKSS-ja nuk ka kufizime politike në komunikimin e ndonjë prej gjetjeve dhe mesazheve të anketës.
- BKS-ja kombinon metoda sasiore dhe cilësore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme.
- Të dhënat mblidhen përmes intervistave sy më sy me të anketuarit e përzgjedhur rastësisht në të gjithë Kosovën nga hulumtuesit e QKSS-së në terren.
- Pyetësi i BKS-së përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura që u lejojnë të anketuarve të japin mendimet e tyre pa mundësi të paracaktuara.
- Mostrimi, pilotimi dhe intervistat janë realizuar nga 22 hulumtues në terren të ekipeve të QKSS-së. Mostra kombëtare nga e cila u hartua hulumtimi paraqet 1,125 ekonomi familjare, pas mostrimit përfaqësues të popullsisë mbi 18 vjeç në Kosovë.
- Ndarja etnike e të anketuarve të intervistuar është: 90 për qind shqiptarë, 7 për qind serbë dhe 3 për qind të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptianë, goranë, kroatë dhe malazezë), duke pasqyruar përbërjen etnike të Kosovës.
- Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodit telefonik, dhe si të tilla përfshihen 8 rajonet e mëposhtme: Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.
- Faza e parë e grupimit gjeografik u bazua në Raportin e Regjistrimit të Kosovës të vitit 2012. Faza e dytë përfshiu grupimin e mostrave sipas zonës së komunës me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit përdori metodën e mostrës së rastësishme duke përdorur metodën e datëlindjes më të afërt.
- Marrja e mostrave të rastit siguron që çdo banor në Kosovë ka probabilitet të barabartë për të qenë i zgjedhur për një intervistë. Duke pasur parasysh mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë prirjet në qëndrimet dhe perceptimet në mesin e të gjithë popullsisë së rritur në Kosovë

në përgjithësi. Marzhi i gabimit është 3 për qind me një interval besueshmërie prej 95 për qind.

- Para fillimit të punës në terren u krye një intervistë pilot në mes të shtatorit 2017 për të testuar realizueshmërinë e pyetësorit. Më pas, ekipi hulumtues raportoi se intervista pilot ishte e suksesshme dhe nuk kishte probleme me instrumentin pilot. Të gjitha intervistat u kryen nga 5 deri në 11 tetor 2017. Përpunimi dhe analiza e të dhënave u realizua duke përdorur softuerin SPSS.
- Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të mbledhura nga të anketuarit dhe demonstrojnë mënyrën si i perceptojnë ata institucionet kosovare.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)

327(497.11:496.51)(048)

Barometri Kosovar i Sigurisë: Edicion Special: Perceptimet e Publikut ndaj Politikës së Jashtme dhe Dialogut me Serbinë. Interpretimi i të dhënave Donika Emini, Donika Marku. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2018 – 48 f. : ilustr, : 21cm.

1.Emini, Donika 2.Marku, Donika

ISBN 978-9951-679-73-2

ISBN 978-9951-679-73-2



9 789951 679732

www.qkss.org